

Vendim nr. 3 datë 16.01.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Anëtare

Fiona Papajorgji, Anëtare

Genti Ibrahimimi, Anëtar

në datën 16.01.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (G) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **GERD GJINARARI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 79, datë 26.06.2019 të Gjykatës së Apelit Korçë; nr. 00-2022-629 (163), datë 14.06.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Shfuqizimi i togfjalëshit “për të dënuarit përsëritës për krime të kryera me dashje”, në paragrafin e tretë të nenit 64 të Kodit Penal.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Korçë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 5, 15, 17, 18, 21, 25, 29, 33, 42, 43, 116, pika 1, 121, pika 1, shkronja “b”, 122, 124, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 2, 3, 6, 7, 8 dhe 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 49, pikat 3, shkronja “e” dhe 4, 50, pika 4, 71, 71/a, 71/b dhe 76 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Gerd Gjinarari është proceduar dhe dënuar penalisht nga gjykata e Milanos, Itali me vendimin e datës 20.01.1997, që ka marrë formë të prerë në datën 16.03.1997, për veprën penale “Falsifikimi i monedhave”. Më pas, kërkuesi është dënuar me burgim të përjetshëm dhe disa dënime të tjera plotësuese nga Gjykata e Krimeve të Rënda Milano, Itali me vendimin nr. 38/99, datë 21.12.1999, që ka marrë formë të prerë në datën 02.02.2001, pasi është deklaruar fajtor për veprat penale “Vrasja me paramendim në rrethana rënduese në dy raste”, “Mbajtja e armëve luftarake”, “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike në formën e organizimit dhe drejtimit të kësaj veprimtarie” dhe “Kryerja e krimit nga banda të armatosura”. Dënimet e dhëna me këto dy vendime janë bashkuar me vendimin nr. 73/2002 të Prokurorisë së Milanos, Itali, duke disponuar përfundimisht dënimin e kërkuesit me burgim të përjetshëm dhe me gjobë. Ekzekutimi i vendimit për bashkimin e dënimeve fillonte nga data 13.02.1998.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesë të prokurorit, me vendimin nr. 14 akti, datë 10.03.2014, ka vendosur njohjen e vendimeve penale të dhëna nga autoritetet e drejtësisë italiane për kërkuesin dhe bazuar në nenin 516 të Kodit Procedurës Penale (*KPP*) ka bërë konvertimin e dënimeve dhe caktimin e një dënimi të vetëm ndaj tij, atë me burgim të përjetshëm.

3. Kërkuesi ka filluar vuajtjen e dënimit në shtetin italian dhe sipas procesverbalit të datës 24.11.2014 “Mbi dorëzimin e të ekstraduarit” të Zyrës Qendrore Kombëtare Interpol-Tirana është ekstraduar në Shqipëri. Prej datës 12.07.2018 vuan dënimin në institutin e ekzekutimit të vendimeve penale, Drenovë, Korçë.

4. Në datën 23.07.2018 kërkuesi i është drejtuar gjykatës, duke kërkuar lirim me kusht. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2019 (1/54), datë 14.02.2019, ka vendosur, ndërmjet të tjerash, pranimin e kërkesës dhe lirim me kusht të kërkuesit, duke e vendosur atë në provë për të gjithë jetën, me arsyetimin se plotësoheshin kërkesat formale të neneve 64 dhe 65 të Kodit Penal (*KP*).

5. Ndaj vendimit kanë paraqitur ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për pranimin e kërkesës dhe kërkuesi për afatin e vënies në provë. Gjykata e Apelit Korçë,

me vendimin nr. 79, datë 26.06.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e kërkesës për lirimin me kusht, duke arsyetuar se vendimi ishte rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit penal, e moszbatimit të vendimit unifikues nr. 2, datë 25.05.2015 të Gjykatës së Lartë, si dhe e vlerësimit të padrejtë të kriterëve ligjore “arsye të veçanta” ose “rast i jashtëzakonshëm”.

6. Kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit, me vendimin nr. 00-2022-629 (163), datë 14.06.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, me arsyetimin se kërkuesi nuk përmbush një prej kushteve të lirit me kusht që lidhet me ndalimin e të dënuarit të jetë përsëritës për krime të kryera me dashje.

7. Në datën 14.11.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit Korçë dhe të Gjykatës së Lartë, si dhe të togfjalëshit “*për të dënuarit përsëritës për krime të kryera me dashje*”, në paragrafin e tretë të nenit 64 të KP-së, si të papajtueshme me Kushtetutën, dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Korçë.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

8.1. Vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

8.1.1. *E drejta për t’u njoftuar rregullisht për datën dhe trupin gjykues të caktuar për shqyrtimin e rekursit të tij në Gjykatën e Lartë*, pasi në rastin konkret gjyqtari relator ka planifikuar dhe ka afishuar në faqen elektronike zyrtare të kësaj gjykate seancat gjyqësore të datave 19.05.2022 dhe 14.06.2022, përkatësisht në datat 06.05.2022 dhe 07.06.2022, pra 13 dhe 7 ditë para zhvillimit të seancës, në kundërshtim me afatin ligjor të përcaktuar në nenin 436, pikat 2 dhe 3, të KPP-së. Ky njoftim nuk rezulton të jetë përcjellë në rrugë elektronike në adresën e avokates së kërkuesit, ndonëse ka qenë e deklaruar dhe e njohur si e tillë nga Gjykata e Lartë. Gjithashtu, sipas informacionit të nxjerrë nga faqja elektronike zyrtare e kësaj gjykate, rezulton se përbërja e trupit gjykues nuk është e njëjtë me atë që ka marrë në shqyrtim rekursin. Ndërkohë që kërkuesit nuk rezulton t’i jetë njoftuar përbërja e trupit të ri gjykues, ndonjë akt

dorëheqjeje, vendim përjashtimi ose zëvendësimi i anëtarëve të trupit gjykues ekzistues.

- 8.1.2. *E drejta për t'u dëgjuar drejtësisht*, në drejtim të pjesëmarrjes në proces dhe në seancë, si dhe në drejtim të respektimit të parimit të barazisë së armëve dhe të marrjes dhe shqyrtimit të provave në favor të tij, pasi Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi, megjithëse çështja paraqitej me problematika dhe me rëndësi nga pikëpamja e së drejtës për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është bazuar vetëm në çështjet e parashtruara në apel nga prokurori, nuk ka marrë dhe as ka vlerësuar drejtësisht provat në favor të të dënuarit, si dhe as ka riparuar këtë të metë të hetimit gjyqësor të Gjykatës së Apelit Korçë.
- 8.1.3. *E drejta për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme*, pasi Gjykata e Lartë e ka paragjykuar çështjen për shkak të njoftimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit lidhur me procedimin disiplinor të gjyqtarit të shkallës së parë që kishte pranuar kërkesën e lirimit me kusht. Gjithashtu, në trupin gjykues të Gjykatës së Lartë që ka vendosur shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar dhe në dhomë këshillimi të rekursit të kërkuarit ka marrë pjesë një gjyqtar, i cili ishte anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor kur ky i fundit zhvilloi procedimin disiplinor të gjyqtarit të shkallës së parë dhe konkludoi se ai kishte zbatuar keq ligjin penal për lirimin me kusht të kërkuarit.
- 8.1.4. *Parimi i sigurisë juridike dhe mosdënimi pa ligj*, në drejtim të parimit të zbatimit të dispozitës penale favorizuese, ndalimit të zbatimit prapaveprues të ligjit në disfavor të individit dhe të aplikimit të nenit 64 të KP-së, pasi Gjykata e Lartë, në kundërshtim me Kushtetutën, ka aplikuar kriterin e ekzistencës së interesit publik për shqyrtimin e çështjes së kërkuarit me procedurë të përshpejtuar dhe në dhomë këshillimi, si dhe ka ripërkufizuar llojin e dënimit të dhënë ndaj kërkuarit. Në vitin 2016, kur kërkuarit i lindi e drejta për të kërkuar lirimin me kusht, ligji penal parashikonte në rastin e të dënuarit me burgim të përjetshëm kushtin që ai të kishte vuajtur jo më pak se 25 vjet burgim. Po kështu, ligji penal italian, mbi bazën e të cilit kërkuari u dënua me burgim të përjetshëm, nuk e parashikon përsëritjen e veprave penale si kriter ndalues për këtë kategori të dënuarish për të përfituar lirimin me kusht.

8.2. Togfjalëshi “*për të dënuarit përsëritës për krime të kryera me dashje*”, në paragrafin e tretë të nenit 64 të KP-së cenon:

- 8.2.1. *Të drejtën për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit çnjerëzor ose poshtërues*, të garantuar nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 3 i KEDNJ-së, për shkak të ndalimit të mundësisë të të dënuarit për të rifituar në një të ardhme lirinë, duke e shndërruar dënimin me burgim të përjetshëm në këto raste në dënim me burgim deri në vdekje.
- 8.2.2. *Parimin e proporcionalitetit*, të garantuar nga neni 17 i Kushtetutës, pasi ndalimi i zbatimit të lirimit me kusht për përsëritësin e krimit me dashje nuk justifikon mjetin e përdorur me qëllimin që kërkohet të arrihet dhe prezumon se dënimi i parë i marrë nga i dënuari nuk ka arritur qëllimin penal të rikthimit të tij në shoqëri si person i risocializuar.
- 8.2.3. *Parimin e drejtësisë në caktimin e dënimit penal*, pasi ky parashikim bie ndesh me pavarësinë funksionale të gjykatës në përcaktimin e përgjegjësisë penale dhe në individualizimin e dënimit penal, si dhe vetë pavarësinë funksionale të pushtetit gjyqësor.
- 8.2.4. *Parimin e barazisë para ligjit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës dhe neni 16 i KEDNJ-së, pasi kufizimi kategorik i lirimit me kusht për të dënuarin përsëritës për një krim të kryer me dashje, nuk e lejon atë të përfitojë nga ky institut, megjithëse mund të ketë plotësuar njëloj kushtet e rehabilitimit sikurse autorët përsëritës të veprave penale të kryera njëherësh në të njëjtin procedim ose procedime të ndryshme, vendimet e dënimit të të cilëve nuk kanë marrë formë të prerë.
- 8.2.5. *Të drejtën e trajtimit njerëzor dhe respektimin e dinjitetit të personit që i është hequr liria*, të garantuar nga neni 28, pika 5, i Kushtetutës, për shkak të ndalimit absolut të zbatimit të lirimit me kusht si dënim alternativ, ndërkohë që ky institut duhet të shërbejë si një mundësi për të dënuarin me burgim që pas ekzekutimit të një pjese të dënimit të ketë mundësinë të risocializohet.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkesit

9. Çështja e legjitimitetit është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

10. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Kolegji vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi në Gjykatën Kushtetuese.

12. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata Kushtetuese bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

13. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individit mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim individual kushtetues, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që

ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor të inicuar prej tij për lirim me kusht. Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimit të kundërshtuar dhe, për rrjedhojë, ai e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

15. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Lidhur me vendimet gjyqësore, nenet 142, pika 1 dhe 146, pika 2, të Kushtetutës parashikojnë detyrimin për arsyetimin e vendimeve gjyqësore dhe shpalljen publikisht të tyre në çdo rast. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, ka llogaritur afatin 4-mujor, duke filluar nga data e dhënies së vendimit nga gjykata, që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe afati për kërkimin që lidhet me shfuqizimin e normës ligjore penale si të të papajtueshme me Kushtetutën dhe me KEDNJ-në, bazuar në nenin 50, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, është brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit. Ky afat llogaritet nga çasti kur akti fillon të prodhojë efekte për kërkuenin ose, thënë ndryshe, kur ndaj tij zbatohet ligji ose akti normativ (*shih vendimet nr. 12, datë 24.05.2022; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në çështjen konkrete, vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi, në të cilin është zbatuar edhe dispozita ligjore penale e kundërshtuar, është dhënë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në datën 14.06.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 14.11.2022, pra pas 5 muajve. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i është njoftuar avokates së tij nga sekretaria e Gjykatës së Lartë në rrugë elektronike, me email-in e datës 14.07.2022 (*shih rubrikën IV, faqe 5, të kërkesës*), por ndërkohë nuk ka paraqitur ndonjë provë për të vërtetuar këtë pretendim. Për më tepër, nuk rezulton që kërkuesi të ketë paraqitur ndonjë provë nëse ai dhe mbrojtësi i tij kanë deklaruar ose kanë bërë të njohur për gjykatën si të dhënë kontakti adresën e postës elektronike të mbrojtësit për qëllime të marrjes së njoftimeve edhe në rrugë elektronike, sipas nenit 436, pika 3, të KPP-së ose pikës 5 të urdhrit nr. 131, datë 02.07.2021 të

zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë “Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve”.

17. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis* për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, pasi ai e ka paraqitur kërkesën jashtë afatit ligjor 4-mujor. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

18. Në përfundim të analizës për kriteret paraprake, Kolegji çmon se çështja nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.